



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 46

Tiranë – E enjte, 6 mars 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 23/2025, datë 27.2.2025	Për miratimin e strukturës dhe organikës së pagave të punonjësve me kohë jo të plotë pune të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në mbështetje të procesit të votimit nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për zgjedhjet e vitit 2025..... 4387
Dekret i Presidentit nr. 80, datë 28.2.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 4387
Dekret i Presidentit nr. 81, datë 28.2.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 4387
Dekret i Presidentit nr. 82, datë 28.2.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 4388
Dekret i Presidentit nr. 83, datë 28.2.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 4388
Dekret i Presidentit nr. 84, datë 28.2.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 4388
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 122, datë 26.2.2025	Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme për vitin 2025..... 4389
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 181, datë 24.2.2025	Për miratimin e rekomandimit GFCM/46/2023/18 mbi skemën e përbashkët ndërkombëtare të inspektimit dhe mbikëqyrjes në ujërat ndërkombëtare në detin Adriatik (nënzona gjeografike 17 dhe 18).... 4391
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 2241/3, datë 28.2.2025	Për hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje ndërkombëtare..... 4399
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Ermir Jahelezi..... 4399

**VENDIM**
Nr. 23/2025**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE ORGANIKËS SË PAGAVE TË PUNONJËSVE ME KOHË JO TË PLOTË PUNE TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE NË MBËSHTETJE TË PROCESIT TË VOTIMIT NGA JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR ZGJEDHJET E VITIT 2025**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 19, shkronja “m”, të ligjit nr. 10 019, datë 28.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:**

I. Miratimin e organikës dhe strukturës së pagave të punonjësve me kohë jo të plotë pune të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në mbështetje të procesit të votimit nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për zgjedhjet e vitit 2025.

II. Struktura, organika dhe klasifikimi i pagave të personelit me kohë jo të plotë pune që rekrutohet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në mbështetje të procesit të votimit nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për realizimin e zgjedhjeve të përgjithshme për Kuvendin të vitit 2025 është sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Elisa Spiropali

Miraturar në datën 27.2.2025.

Lidhja nr. 1

Njësitë përgjegjëse	Pozicioni i punës	Kategoria e pagës	Perioda e punësimit	Numri i punonjësve	Kriteret e punësimit
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ADMINISTRIMIT TË ZGJEDHJEVE					
Drejtoria për Votimin nga Jashtë					
Sektori i Administrimit dhe Zhvillimit të Votimit	Specialist	IV-2	6 muaj	5	Arsim i lartë
	Specialist	IV-2	3 muaj	55	Arsim i lartë
	Operator	V	3 muaj	20	Arsim i mesëm

DEKRET
Nr. 80, datë 28.2.2025**PËR DHËNIE TË SHKETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënen e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:

1. Marta Laš Zadrima

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**DEKRET**
Nr. 81, datë 28.2.2025**PËR DHËNIE TË SHKETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,



DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetas:

1. Moneta Nevzat Kamberi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 82, datë 28.2.2025

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; neneve 16 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Niko Kostandin Roça

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 83, datë 28.2.2025

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetas:

1. Bubulina Milazim Krasniqi Kallaba

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 84, datë 28.2.2025

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Andi Llesh Rroku



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 122, datë 26.2.2025

**PËR MARRJEN E MASAVE DHE
MONITORIMIN E VEPRIMTARISË,
SJELLJES APO PËRDORIMIT TË
BURIMEVE NJERËZORE TË
ADMINISTRATËS SHTETËRORE, GJATË
PROCESIT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET
E PËRGJITHSHME PËR VITIN 2025**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, pika 7, 63, pika 4, e 91, pika 3, të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, dhe të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme për vitin 2025, me qëllim nxitjen e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve e partive politike në marrëdhëniet me administratën shtetërore dhe burimet e saj, për krijimin e kushteve të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike në procesin elektoral, si dhe për mospërdorimin e burimeve publike për qëllime partiake.

2. Në kuptim të këtij vendimi:

a) **“Administratë shtetërore”**, ndaj së cilës zbatohet ky vendim, është administrata nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, sipas nenit 1, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ku përfshihen institucionet e përmendura në pikën 2, të nenit 4, të këtij ligji, si dhe institucionet, që

funksionojnë me vetëfinancim dhe shoqëritë aksionare publike;

b) **“Punonjës të administratës shtetërore”**, pjesë të institucioneve dhe shoqërive aksionare publike të përmendura në shkronjën “a”, të kësaj pike, ndaj të cilëve zbatohet ky vendim, sipas statusit të tyre, janë nëpunësit civilë dhe punonjësit administrativë, në përputhje me përkufizimet e dhëna në nenin 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe punonjësit e tjerë civilë, marrëdhëniet e punës së të cilëve rregullohen me Kodin e Punës apo legjislacion tjetër specifik, të ndryshëm nga ai i shërbimit civil;

c) **“Funksionarë kabineti”** janë nëpunës të administratës, sipas përkufizimit të nenit 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ndaj të cilëve nuk zbatohet ky vendim;

ç) **“Punonjës policie”**, punonjës të shërbimit të jashtëm, të përmendur në nenin 3, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe punonjës të tjerë, statusi i të cilëve ose elemente të tjera rregullohen me ligje të posaçme, janë punonjës të administratës shtetërore, ndaj të cilëve, përveç dispozitave të përgjithshme të këtij vendimi, do të zbatohen edhe dispozitat e veçanta për secilën prej kategorive të përmendura, për çdo rast, në mënyrë të drejtpërdrejtë në këtë vendim.

3. Punonjësit të administratës shtetërore, gjatë periudhës së procesit zgjedhor, i krijohen kushtet e nevojshme dhe i garantohet moscenimi i të drejtave dhe lirive themelore, kushtetuese, për të shprehur fjalën e lirë dhe për të marrë pjesë në veprimtari politike, brenda kufizimeve dhe ndalimeve, të përcaktuara me dispozita të veçanta të legjislacionit në fuqi, që rregullojnë dhe janë të vlefshme gjatë këtij procesi zgjedhor.

4. Punonjësit të administratës shtetërore, gjatë orarit zyrtar të punës dhe brenda mjediseve të institucioneve shtetërore, i ndalohet çdolloj pjesëmarrjeje në veprimtari politike apo fushatë zgjedhore të një partie politike ose kandidati në zgjedhje.

5. Punonjësi i administratës shtetërore, pas orarit zyrtar të punës dhe jashtë mjediseve të institucioneve shtetërore, ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike apo zgjedhore të një partie politike ose kandidati në zgjedhje, por pa shprehur publikisht bindjet apo preferencat e tij politike.

6. Nëpunësit civil, gjatë pjesëmarrjes në veprimtari, sipas pikës 5, të këtij vendimi, në kuptim



të nenit 37, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, i ndalohet:

a) të bëjë fushatë për një subjekt zgjedhor apo kandidat;

b) të manifestojë me pankarta, parrulla apo çdo mjet tjetër të shkruar dhe të ekspozuar publikisht;

c) të jetë protagonist në aktivitetet/veprimtaritë politike apo të kandidatëve.

7. Punonjësit të Policisë së Shtetit i ndalohet të mbështesë fushatën e një partie, organizate politike, të një anëtarit partie politike apo të një kandidati të pavarur, duke marrë pjesë ose kontribuar fizikisht ose financiarisht.

8. Punonjësit të Gardës së Republikës i ndalohet:

a) të sillt dhe të mbajë qëndrime që cenojnë natyrën e depolitizuar të Gardës;

b) anëtarësimi e pjesëmarrja në veprimtari të partive a të shoqatave politike apo të kandidatëve.

9. Punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit i ndalohet:

a) të manifestojë sjellje dhe të mbajë qëndrime, që cenojnë natyrën e depolitizuar të institucionit;

b) anëtarësimi dhe pjesëmarrja në veprimtari të partive apo të shoqatave politike, apo të kandidatëve;

c) të bëjë propagandë në favor ose kundër partive, shoqatave politike ose kundër kandidatëve në zgjedhje.

10. Ushtarakut aktiv të Forcave të Armatosura i ndalohet të marrë pjesë në veprimtari të politike që organizohen nga parti të politike, organizatat ose shoqatat me karakter politik apo nga kandidatët.

11. Punonjësit të administratës shtetërore i ndalohet të përdorë të mirat publike, funksionin ose veprimtarinë shtetërore, ose burimet financiare a njerëzore, me qëllim favorizimin e një partie politike ose kandidati në zgjedhje.

12. Titullarët e ministrive dhe/ose drejtuesit e institucioneve të varësisë ose personat e ngarkuar prej tyre:

a) organizojnë menjëherë punën dhe marrin masat e nevojshme për garantimin e zbatimit të detyrimeve ligjore për ndalimin e vënies në përdorim për subjektet zgjedhore të veprimtarisë së tyre institucionale, mjeteve, fondeve e materialeve të ndryshme, pronë e administratës shtetërore, si dhe të burimeve njerëzore të institucioneve të administratës shtetërore, të çdo niveli, për zgjedhjet e përgjithshme të datës 11 maj 2025;

b) kontrollojnë në mënyrë periodike veprimtarinë e nëpunësve nën varësinë e tyre, me qëllim

shmangien dhe parandalimin e nxitjes apo kërkesës për përfshirjen e punonjësve të administratës shtetërore në veprimtari politike apo në mbështetje të një partie politike ose kandidati në zgjedhje;

c) verifikojnë dhe analizojnë të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me përdorimin e mjeteve, fondeve e materialeve të ndryshme, si dhe mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë institucionale, gjatë periudhës përpara fillimit dhe gjatë fushatës zgjedhore, në funksion të evidentimit të përdorimit ose jo të tyre për qëllime elektorale;

ç) marrin masa dhe realizojnë monitorimin e zbatimit të tyre për të garantuar mospërdorimin e burimeve njerëzore të institucionit në funksion të veprimtarisë së fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore, të regjistruara për këto zgjedhje, në zbatim të nenit 14, të ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;

d) marrin masa për pezullimin nga detyra të nëpunësve civilë të institucioneve të tyre, të cilët janë regjistruar si kandidatë për zgjedhjet e përgjithshme të datës 11 maj 2025, në zbatim të përcaktimeve të pikës 4, të nenit 63, të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 37, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar. Për nëpunësit e tjerë, marrëdhënia e punës së të cilëve rregullohet nga Kodi i Punës, merren masa, sipas rastit, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës apo pezullimin nga detyra në rastet kur rezultojnë që janë regjistruar si kandidatë për zgjedhjet e përgjithshme të datës 11 maj 2025.

13. Departamenti i Administratës Publike merr masat e nevojshme që gjatë fushatës zgjedhore të mos publikojë vendet vakante të shërbimit civil të institucioneve të administratës shtetërore dhe të pezullojë të gjitha fazat e proceseve të rekrutimit në shërbimin civil në institucionet e administratës shtetërore, të nisura para datës 11 prill 2025.

14. Institucionet dhe shoqëritë aksionare publike, pjesë e administratës shtetërore që punësojnë punonjës, marrëdhënia e punësimit së të cilëve rregullohet sipas dispozitave të Kodit të Punës apo legjislacioni tjetër specifik, të ndryshëm nga ai i shërbimit civil, pezullojnë procedurat e rekrutimit dhe të emërimit të nëpunësve/punonjësve për periudhën 3 mars 2025–11 maj 2025. Procedurat e rekrutimit të nisura në këto institucione përpara datës 3 mars 2025 vijojnë të përmbyllen, por, në çdo rast, përpara datës 11 prill 2025. Bëjnë përjashtim



nga ky rregull rastet e jashtëzakonshme kur për shkak të mungesës së personelit cenohet vijimësia e dhënies së shërbimeve për qytetarët nga institucionet e infrastrukturës kritike, shëndetësia, arsimi dhe mbrojtja, për të cilët ky detyrim zbatohet për periudhën e fushatës zgjedhore.

15. Moszbatimi i rregullave dhe i detyrimeve të parashikuara në këtë vendim passjell përgjegjësi disiplinore dhe ligjore, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

16. Ngarkohen ministrat, titullarët e institucioneve të administratës shtetërore dhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

URDHËR
Nr. 181, datë 24.2.2025

**PËR MIRATIMIN E REKOMANDIMIT
GFCM/46/2023/18 MBI SKEMËN E
PËRBASHKËT NDËRKOMBËTARE TË
INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES NË
UJËRAT NDËRKOMBËTARE NË
DETIN ADRIATIK (NËNZONA
GJEORAFIKE 17 DHE 18)**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 3, të “Marrëveshjes për krijimin e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun”, të ratifikuar me ligjin nr. 9093, datë 3.7.2003, të neneve 13 dhe 14, të ligjit nr. 64, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Zbatimin e rekomandimit GFCM/46/2023/18 mbi skemën e përbashkët ndërkombëtare të inspektimit dhe mbikëqyrjes në ujërat ndërkombëtare në detin Adriatik (nënzona gjeografike 17 dhe 18), që i bashkëlidhen këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Inspektorati që mbulon fushën e peshkimit merr pjesë në skemën e përbashkët ndërkombëtare të inspektimit dhe mbikëqyrjes në ujërat ndërkombëtare në detin Adriatik (nënzona

gjeografike 17 dhe 18), në vijim skema e përbashkët ndërkombëtare.

3. Inspektorati që mbulon fushën e peshkimit përzgjedh inspektorët të cilët do të marrin pjesë në skemën e përbashkët ndërkombëtare dhe dërgon brenda datës 15 nëntor të çdo viti në Drejtorinë e Politikave, Strategjisë dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës listën e emrave të inspektorëve të përzgjedhur.

4. Drejtoria e Politikave, Strategjisë dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, brenda datës 1 dhjetor të çdo viti, dërgon në GFCM listën e emrave të inspektorëve të autorizuar për të kryer inspektim dhe mbikëqyrje në zonën që mbulohet nga GFCM-ja.

5. Inspektorët e autorizuar për të kryer inspektim dhe mbikëqyrje në zonën që mbulohet nga GFCM-ja zbatojnë rregullat dhe detyrimet e përcaktuara në Rekomandimin GFCM/46/2023/18.

6. Inspektorët mbajnë dokumentacionin përkatës të identifikimit të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, i cili ndjek formatin e dhënë në aneksin 1 të Rekomandimit GFCM/46/2023/18.

7. Brenda datës 31 dhjetor të çdo viti, inspektorët pjesëmarrës në skemën e përbashkët ndërkombëtare, përgatisin një raport të detajuar i cili përshkruan aktivitetet e zhvilluara në kontekstin e kësaj skeme, kontrollat e zhvilluara, masat administrative të marra, vëzhgimet, pikasjet dhe çdo informacion relevant mbi skemën.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Politikave, Strategjisë dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe inspektorati që mbulon fushën e peshkimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL**
Anila Denaj

**REKOMANDIMI GFCM/46/2023/18 MBI
SKEMËN E PËRBASHKËT
NDËRKOMBËTARE TË INSPEKTIMIT DHE
MBIKËQYRJES NË UJËRAT
NDËRKOMBËTARE NË DETIN ADRIATIK
(NËNZONA GJEORAFIKE 17 DHE 18)**

Komisioni i Përgjithshëm i Peshkimit për Mesdheun (GFCM),



duke marrë parasysh se objektivi i “Marrëveshjes për krijimin e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun” (Marrëveshja e GFCM-së) është të sigurojë ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm, në nivel biologjik, social, ekonomik dhe mjedisor, të burimeve të gjalla detare në zonën e zbatimit të GFCM-së;

duke rikujtuar se, në zbatim të objektivit të Marrëveshjes së GFCM-së, GFCM-ja duhet të miratojë rekomandime mbi masat e ruajtjes dhe menaxhimit që synojnë sigurimin e qëndrueshmërisë afatgjatë të aktiviteteve të peshkimit, me qëllim ruajtjen e burimeve të gjalla detare dhe qëndrueshmërinë ekonomike dhe sociale të peshkimit dhe se, në miratimin e këtyre rekomandimeve, GFCM-ja duhet t'i kushtojë një vëmendje të veçantë masave për parandalimin e mbipeshkimit dhe minimizimin e hedhurinave, si dhe ndikimeve të mundshme mbi peshkimin në shkallë të vogël dhe komuniteteve lokale;

duke rikujtuar se, në zbatim të objektivit të Marrëveshjes së GFCM-së, GFCM-ja duhet të nxisë, sipas rastit, një qasje nënrajonale për menaxhimin e peshkimit dhe zhvillimin e akuakulturës, me qëllim adresimin më të mirë të specifikave të Mesdheut dhe Detit të Zi;

duke rikujtuar Rekomandimin GFCM/41/2017/7 mbi një plan veprimi rajonal për të luftuar peshkimin e paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar në zonën e zbatimit të GFCM-së;

duke vërejtur përfundimet e sesionit të gjashtëmbëdhjetë të Komitetit të Përputhshmërisë (CoC) (Greqi, maj 2023), i cili ra dakord të zhvillojë një skemë të re të përhershme inspektimi për peshkimin e pelagjikëve të vegjël dhe fundor në detin Adriatik;

duke rikujtuar se Rekomandimi GFCM/43/2019/5 mbi një plan menaxhimi shumëvjeçar për një peshkim të qëndrueshëm fundor në detin Adriatik (në nënzonat gjeografike 17 dhe 18), parashikonte miratimin e një skeme të përhershme inspektimi deri në fund të vitit 2020;

duke rikujtuar se Rekomandimi GFCM/44/2021/20 mbi një plan menaxhimi shumëvjeçar për shfrytëzimin e qëndrueshëm të pelagjikëve të vegjël në detin Adriatik (në nënzonat gjeografike 17 dhe 18) parashikon miratimin e një skeme të përhershme inspektimi në vitin 2023;

duke marrë parasysh Strategjinë 2030 të GFCM-së për peshkimin dhe akuakulturën e qëndrueshme në

Mesdhe dhe Detin e Zi, veçanërisht pikën 2.3 “Monitorimi, kontrolli dhe mbikëqyrja të centralizuara në nivel rajonal” dhe planin e saj të veprimit, i cili parashikon dakordësinë mbi procedura të përbashkëta për shkëmbimin e inspektorëve dhe raporteve të inspektimit dhe promovimin e përfundimit të marrëveshjeve ndërmjet palëve kontraktuese dhe palëve jokontraktuese bashkëpunuese (CPC) për implementimin e skemave të përbashkëta të mbikëqyrjes dhe inspektimit në nivelet rajonale dhe nënrajonale;

duke rikujtuar se Rezoluta GFCM/44/2021/11 mbi pasojat e rishikimit të dytë të performancës së GFCM-së kërkon krijimin e skemave të reja të inspektimit të përbashkët ndërkombëtar dhe zbatimin e atyre aktualisht në zbatim, për të siguruar monitorim të duhur;

miraton, në përputhje me nenet 5, germa “b”, 8, “b” dhe 13 të Marrëveshjes së GFCM-së, rekomandimin e mëposhtëm:

PJESA I

QËLLIMI DHE PARIMET E PËRGJITHSHME

1. Ky rekomandim krijon një skemë ndërkombëtare të përbashkët të inspektimit dhe mbikëqyrjes (nga ky moment “skema”), e cila ka një përkufizim të kufizuar në dispozitat e rekomandimeve GFCM/44/2021/20 dhe GFCM/43/2019/5, të cilat mbulojnë aktivitetet e inspektimit dhe mbikëqyrjes jashtë ujërave nën juridiksionin kombëtar në detin Adriatik (nënzona gjeografike 17 dhe 18).

2. Çdo CPC vendos në mënyrë vullnetare për të marrë pjesë në inspektime. Inspektimet do të kryhen nga inspektorë të përzgjedhur nga CPC-të. Çdo CPC duhet të raportojë te Sekretariati i GFCM-së, jo më vonë se 1 dhjetori i çdo viti, listën e emrave të inspektorëve të autorizuar për të kryer inspektim dhe mbikëqyrje në zonën e aplikimit të GFCM-së. Lista e plotë e inspektorëve do të publikohet dhe do të mirëmbahet nga Sekretariati i GFCM-së në portalin e tij *online* të siguruar dhe të mbrojtur me fjalëkalim.

3. Inspektorët duhet të mbajnë dokumentacionin përkatës të identifikimit të lëshuar nga autoritetet e shtetit flamur, i cili duhet të ndjekë formatin e dhënë në aneksin 1.



4. Emrat e anijeve dhe skafeve të përdorur për inspektim dhe mbikëqyrje duhet të raportohen nga CPC-të pjesëmarrëse, te Sekretariati i GFCM-së deri më 15 dhjetor të vitit të mëparshëm ose sa më shpejt të jetë e mundur para fillimit të aktiviteteve të inspektimit. Sekretariati i GFCM-së duhet të vërë në dispozicion të të gjitha CPC-ve informacionin në lidhje me anijet dhe skafet e përcaktuara për inspektim, duke i postuar, gjithashtu, në një portal *online* të mbrojtur me fjalëkalim.

5. Anijet që kryejnë imbarkimin dhe inspektimin në përputhje me skemën, do të vendosin një flamur ose banderola speciale, siç përshkruhet në aneksin 2, e miratuar nga GFCM-ja dhe e përcaktuar nga Sekretariati i GFCM-së.

6. Sekretariati i GFCM-së do të sigurojë që informacioni i referuar më sipër t'u bëhet automatikisht i disponueshëm të gjitha CPC-ve.

7. Një CPC mund, me marrëveshje të ndërsjellë me një CPC tjetër, të imbarkojë inspektorët që ka caktuar në skemë, në një anije inspektimi të një CPC-je tjetër. Kjo CPC duhet të njoftojë Sekretariatit e GFCM-së paraprakisht për një dërgim të tillë.

8. Çdo CPC duhet të sigurojë që çdo anije inspektimi e autorizuar për të mbajtur flamurin e saj dhe që operon në zonën e aplikimit të GFCM-së të mbajë kontakt të sigurt, në mënyrë ditore ku të jetë e mundur, me çdo anije tjetër inspektimi që operon në zonën e aplikimit të GFCM-së, për të shkëmbyer informacionin e nevojshëm për të koordinuar aktivitetet e tyre.

9. Çdo CPC me prani inspektimi në zonën e aplikimit të GFCM-së duhet të sigurojë që inspektorët e saj trajtojnë anijet që operojnë në zonën e aplikimit të GFCM-së në të njëjtat kushte, duke shmangur një numër të pabarabartë inspektimesh të anijeve me flamurin e ndonjë CPC-je tjetër.

10. Çdo CPC me prani inspektimi ose mbikëqyrjeje në zonën e aplikimit të GFCM-së duhet t'i sigurojë çdo anijeje inspektimi, me hyrjen e saj në zonën e aplikimit të GFCM-së, një listë të vëzhgimeve, imbarkimeve dhe inspektimeve që ka kryer gjatë periudhës së mëparshme dhjetëditore, përfshirë datat, koordinatat dhe çdo informacion tjetër të rëndësishëm.

PJESA II ZHVILLIMI I INSPEKTIMIT

11. Çdo CPC pjesëmarrës në inspektim duhet të sigurojë që inspektorët e saj:

a) të njoftojnë anijen e peshkimit, para se të hipin në bord, për emrin e anijes së inspektimit;

b) të shfaqin në anijen e inspektimit dhe në çdo anije tjetër ndihmëse, flamurin e përcaktuar në aneksin 2;

c) të sigurojnë që, gjatë hipjes në bord, anija e inspektimit të qëndrojë në një distancë të sigurt nga anijet e peshkimit;

d) të mos kërkojnë nga anija e peshkimit të ndalojë ose të manovrojë gjatë operacioneve të peshkimit; dhe

e) të kufizojnë çdo ekip inspektimi në maksimum tre inspektorë.

12. Pas hipjes në anije, inspektorët duhet t'i paraqesin kapitenit të anijes së peshkimit kartën e identitetit të përshkruar në aneksin 1. Inspektimet duhet të kryhen në një nga gjuhët zyrtare të GFCM-së dhe, kur është e mundur, në gjuhën që flet kapiteni i anijes së peshkimit.

13. Inspektorët duhet të kryejnë inspektimet në përputhje me rregulloret, procedurat dhe praktikat ndërkombëtare që lidhen me sigurinë e anijes së inspektuar dhe ekuipazhit të saj, të minimizojnë ndërhyrjet në aktivitetet e peshkimit ose në magazinimin e produkteve dhe, brenda mundësive, të shmangin veprimet që mund të ndikojnë negativisht në cilësinë e zënies në bord.

14. Inspektorët duhet të kufizojnë pyetjet e tyre për të përcaktuar respektimin e Rekomandimit GFCM/43/2019/5 dhe Rekomandimit GFCM/44/2021/20. Gjatë kryerjes së inspektimit, inspektorët mund t'i kërkojnë kapitenit të anijes së peshkimit çdo ndihmë që mund t'u nevojitet. Inspektorët duhet të hartojnë një raport të inspektimit duke përdorur formularin e dhënë në aneksin 4.

15. Inspektorët duhet të nënshkruajnë raportin e inspektimit në prani të kapitenit të anijes, i cili, gjithashtu, duhet ta nënshkruajë raportin dhe ka të drejtë të shtojë çdo vërejtje që mund ta konsiderojë të përshtatshme.

16. Kopje të raportit duhet t'i jepen kapitenit të anijes dhe institucioneve të palës inspektuese, e cila duhet të përcjellë kopjet tek autoritetet përkatëse të shtetit të flamurit të anijes së inspektuar dhe Sekretariatit të GFCM-së.



17. Madhësia e trupës inspektuese dhe kohëzgjatja e inspektimit duhet të përcaktohen nga oficeri komandues i anijes së inspektimit, duke marrë parasysh rrethanat përkatëse. Në përgjithësi, pala inspektuese duhet të përfundojë detyrat e saj në kohën më të shkurtër të mundshme.

18. Për qëllim të këtyre procedurave, shkelje nënkupton shkeljet e vërejtura në përputhje me dispozitat e Rekomandimit GFCM/43/2019/5 dhe Rekomandimit GFCM/44/2021/20:

a) peshkimi pa një licencë, leje ose autorizim të vlefshëm të lëshuar nga CPC i flamurit;

b) mosmbajtja e regjistrimeve të mjaftueshme të zënieve dhe të dhënave të lidhura me zëniet, në përputhje me kërkesat e raportimit të të dhënave të GFCM-së ose raportimi i pasaktë i këtyre të dhënave të zënies dhe/ose të dhënave të lidhura me zëniet;

c) peshkimi në një zonë të ndaluar;

d) peshkimi gjatë një sezoni ndalimi;

e) përdorimi i veglave të ndaluara të peshkimit;

f) falsifikimi ose fshehja e qëllimshme e shenjave, identitetit ose regjistrimit të një anijeje peshkimi;

g) fshehja, ndryshimi ose hedhja e provave që lidhen me hetimin e një shkeljeje;

h) kryerja e shkeljeve të shumta, të cilat, të marra së bashku, përbëjnë një mosrespektim serioz të masave të zbatueshme;

i) bllokimi, intimidimi, ndërhyrja ose ndalimi i inspektorëve të autorizuar për të kryer detyrat e tyre; dhe/ose

j) ndërhyrja me sistemin e monitorimit satelitor dhe/ose operimi pa një sistem monitorimi të anijes (VMS).

19. Në rastin e çdo imbarkimi dhe inspektimi të një anijeje peshkimi gjatë të cilit inspektorët vërejnë një aktivitet ose kushte që do të përbënin një shkelje, siç është përcaktuar më sipër, autoritetet e shtetit të flamurit të anijes së inspektimit duhet të njoftojnë menjëherë shtetin e flamurit të anijes së peshkimit, si dhe përmes Sekretariatit të GFCM-së. Në një situatë të tillë, inspektori, gjithashtu, duhet të informojë çdo anije inspektimi të shtetit të flamurit të anijes së peshkimit që ndodhet në afërsi.

20. Inspektorët e GFCM-së duhet të regjistrojnë inspektimet e kryera dhe shkeljet e zbuluara (nëse ka) në regjistrin e anijes së peshkimit (*logbook*).

21. CPC i shtetit të flamurit të inspektuar duhet të sigurojë që, pas inspektimit të përmendur më sipër, anija e peshkimit përkatëse të ndalojë të gjitha aktivitetet e peshkimit. CPC i shtetit të flamurit

duhet t'i kërkojë anijes së peshkimit të shkojë brenda 72 orësh në një port të caktuar prej tij, ku do të fillohet një hetim.

22. Në rastin e një inspektimi që ka zbuluar një aktivitet ose kusht që do të përbënte një shkelje, veprimet dhe ndjekja e ndërmarrë nga CPC i shtetit të flamurit duhet t'i njoftohet autoriteteve të tij kombëtare, si dhe Sekretariatit të GFCM-së, për t'u shqyrtuar nga CoC.

23. Rezistenca ndaj inspektorëve ose mosrespektimi i udhëzimeve të tyre do të trajtohen nga shteti i flamurit të anijes së inspektuar në një mënyrë të ngjashme me rezistencën ndaj një inspektori kombëtar ose mosrespektimin e udhëzimeve të tij.

24. Autoritetet e CPC-ve duhet të shqyrtojnë dhe të veprojnë në raportet e inspektimit, siç parashikohet në aneksin 4, raportet e pikasjes, siç parashikohet në aneksin e Rekomandimit GFCM/46/2023/21 për pikasjen e anijeve, që ndryshon Rekomandimin GFCM/44/2021/21, dhe deklaratat që rrjedhin nga inspektimet e inspektorëve të huaj në kuadër të këtyre rregulimeve, në një bazë të ngjashme me raportet e inspektorëve kombëtarë, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar.

PJESA III

DETYRIMET E KAPITENIT TË ANIJES GJATË INSPEKTIMIT

25. Kapiteni i anijes së peshkimit që po inspektohet duhet:

a) të lehtësojë imbarkimin e sigurt dhe efektiv të inspektorëve, në përputhje me praktikën e mirë të lundrimit, kur jepet sinjali i duhur sipas Kodit Ndërkombëtar të Sinjalistikës ose kur qëllimi për të hipur në bord është përcaktuar përmes radiokomunikimit nga një anije ose helikopter që transporton një funksionar;

b) të sigurojë një shkallë hipjeje që plotëson kërkesat e aneksit 3 për të lehtësuar aksesin e sigurt dhe të përshtatshëm në çdo anije që kërkon një ngjitje prej 1.5 m ose më shumë;

c) të lehtësojë detyrat e inspektorëve, duke ofruar ndihmë kur kërkohet në mënyrë të arsyeshme;

d) të lejojë inspektorët të komunikojnë me autoritetet e shtetit të flamurit, shtetit bregdetar dhe shtetit inspektues;



e) të njoftojë inspektorët për rreziqet e veçanta të sigurisë në bord të anijeve të peshkimit;

f) t'i sigurojë funksionarëve akses në të gjitha zonat e anijes, të gjitha kapjet e përpunuara ose të papërpunuara, të gjitha pajisjet e peshkimit dhe të gjitha informacionet dhe dokumentet përkatëse;

g) të lehtësojë zbritjen e sigurt të inspektorëve pas përfundimit të inspektimit;

h) sipas kërkesës së inspektorit, të heqë çdo pjesë të pajisjeve të peshkimit që nuk duket se është në përputhje me rekomandimet e GFCM-së në fuqi; dhe

i) kur inspektori ka bërë ndonjë hyrje në regjistrat e anijes, të sigurojë inspektorin me një kopje të çdo faqeje ku shfaqen këto hyrje dhe, sipas kërkesës së inspektorit, të nënshkruajë çdo faqe për të konfirmuar se është një kopje e vërtetë.

PJESA IV DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

26. Ky rekomandim do të zbatohet në vitin 2024, në përputhje me kapacitetin e CPC-ve, dhe do të zbatohet plotësisht nga të gjitha CPC-të përkatëse në vitin 2025.

27. Dispozitat e këtij rekomandimi do të zbatohen deri në vitin 2026 për të përcaktuar respektimin e Rekomandimit GFCM/43/2019/5 dhe deri në vitin 2028 për të përcaktuar respektimin e Rekomandimit GFCM/44/2021/20.

28. CoC do të monitorojë dhe do të raportojë në GFCM në sesionin e tij të dyzet e tetë për zbatimin e kësaj skeme. GFCM-ja do të shqyrtojë çdo rekomandim për përmirësimin e zbatimit të skemës.

ANEKS 1


FORMATI I DOKUMENTIT IDENTIFIKUES PËR INSPEKTORËT E GFCM-së

General Fisheries Commission for the Mediterranean (GFCM)			GFCM
	GFCM	<i>The holder of this inspector identity card is a GFCM inspector duly appointed under the terms of the GFCM Joint Inspection and Surveillance Scheme and has the power to act under the provisions of GFCM rules.</i>	
INSPECTOR IDENTITY CARD			
<i>Photograph</i>	<i>Contracting party</i>		
	<i>Inspector's name</i>		
	<i>Card n°</i>		<i>Issuing authority</i>
	<i>Issue date:</i>	<i>Valid for five years</i>	

Përmasat: 10 cm gjerësi, 7 cm gjatësi.

ANEKS 2

MODELI I FLAMURIT QË PËRDORET GJATË SKEMËS SË PËRBASHKËT
NDËRKOMBËTARE TË INSPEKTIMIT TË GFCM-së



Flamuri të vendoset nga anijet inspektuese të GFCM-së. Gjithashtu, edhe anijet ndihmëse duhet të vendosin të njëjtin flamur, i cili mund të jetë me përmasa të përgjysmuara.

ANEKS 3

NDËRTIMI DHE PËRDORIMI I SHKALLËVE TË IMBARKIMIT

1. Dispozitat e këtij aneksi zbatohen për të siguruar akses të sigurt dhe të përshtatshëm në anijet e peshkimit që kërkojnë një ngjitje prej 1.5 m ose më të madhe.

2. Duhet të sigurohet një shkallë imbarkimi që të jetë efektive për qëllimin e lehtësimit të imbarkimit dhe zbarkimit të sigurt të inspektorëve në det. Shkalla e imbarkimit duhet të mbahet e pastër dhe në gjendje të mirë.

3. Të sigurohet që shkalla:

- a) të vendoset jashtë trajektores së shkarkimeve të mundshëm nga anija;
- b) sa të jetë e mundur, të vendoset në pjesën e drejtë të anijes, në mes të gjatësisë së anijes; dhe
- c) të mbështetet fort kundër anës së anijes.

4. Shkallët e imbarkimit duhet të:

a) jenë prej druri të fortë ose çdo materiali tjetër me veti të barasvlershme, të bëra në një pjesë të vetme; katër shkallët më të ulëta mund të jenë prej gome me qëndrueshmëri dhe fortësi të mjaftueshme ose prej një materiali tjetër të përshtatshëm me karakteristika të ngjashme;

b) kenë një sipërfaqe efektive kundër rrëshqitjes;

c) kenë gjatësi jo më pak se 480 mm, gjerësi 115 mm dhe trashësi 23 mm, pa përfshirë veshjet kundër rrëshqitjes;

d) jenë të shpërndarë në mënyrë të barabartë, me distancë jo më pak se 300 mm dhe jo më shumë se 380 mm nga njëra-tjetra; dhe

e) jenë të siguruar në mënyrë të tillë që të qëndrojnë në pozicion horizontal.

5. Asnjë shkallë imbarkimi nuk duhet të ketë më shumë se dy shkallë zëvendësuese, të cilët duhet të jenë të siguruar në pozicion me një metodë të ndryshme nga ajo e përdorur në ndërtimin original të shkallës. Çdo shkallë e tillë duhet të zëvendësohet sa më shpejt që të jetë e mundur me shkallët e siguruar në pozicion, duke përdorur metodën e ndërtimit original të shkallës. Kur ndonjë shkallë zëvendësues sigurohet në litarët



anësorë të shkallës së imbarkimit nëpërmjet brazdave në anë të shkallës, këto brazda duhet të jenë të vendosura në anët më të gjata të shkallëve.

6. Litarët anësorë të shkallës duhet të përbëhen nga dy litarë “manila” të pambuluar ose litarë ekuivalentë me një perimetër jo më pak se 60 mm në secilën anë; çdo litar duhet të mbetet i pambuluar nga ndonjë material tjetër dhe të jetë i vazhdueshëm, pa nyje. Dy litarë kryesorë, të siguarur siç duhet në anije dhe me një perimetër jo më pak se 65 mm, si dhe një litar sigurie, duhet të mbahen pranë dhe të jenë gati për përdorim nëse kërkohet.

7. Duhet të sigurohen shtylla prej druri të fortë ose materiali tjetër me veti të barasvlershme, në një copë pa nyje dhe me gjatësi ndërmjet 1.8 dhe 2 m, në intervale të tilla që të parandalojnë kthesën e shkallës së imbarkimit. Shtylla më e ulët duhet të jetë në shkallën e pestë nga fundi i shkallës, dhe distanca ndërmjet çdo shtylle nuk duhet të kalojë nëntë shkallë.

8. Duhet të sigurohen mjete për të garantuar kalimin e sigurt dhe të përshtatshëm të inspektorëve që po imbarkohen ose zbarkohen nga anija, midis shkallës së imbarkimit ose çdo shkalle akomodimi ose pajisjeje tjetër. Kur ky kalim bëhet përmes një porte në hekurat, duhet të sigurohen mbajtëse të mjaftueshme. Kur kalimi bëhet përmes një shkalle bordin, kjo shkallë duhet të jetë e siguar fort në hekurin ose platformën e bordit dhe dy mbajtëse duhet të vendosen në pikën e imbarkimit ose zbarkimit nga anija, jo më pak se 0.70 m dhe jo më shumë se 0.80 m larg njëra-tjetrës. Çdo mbajtëse duhet të jetë e siguar fort në strukturën e anijes në ose pranë bazës së saj dhe, gjithashtu, në një pikë më të lartë, të ketë një diametër jo më pak se 40 mm dhe të shtrihet jo më pak se 1.20 m mbi majën e bordit.

9. Duhet të sigurohet ndriçim gjatë natës në mënyrë që si shkalla e imbarkimit ashtu edhe vendi ku inspektori imbarkon në anije të jenë të ndriçuara siç duhet. Një bovë shpëtimi e pajisur me një dritë vetëndriçuese duhet të mbahet pranë, gati për t'u përdorur. Po ashtu, një litar shpëtimi duhet të mbahet pranë, gati për t'u përdorur nëse kërkohet.

10. Duhet të sigurohen mjete që të mundësojnë përdorimin e shkallës së imbarkimit në secilën anë të anijes. Inspektori përgjegjës mund të tregojë se në cilën anë dëshiron që shkalla e imbarkimit të vendoset.

11. Përgatitja e shkallës dhe imbarkimi, dhe zbarkimi i inspektorëve do të mbikëqyren nga një oficer përgjegjës i anijes. Oficeri përgjegjës do të jetë në kontakt radio me urën e anijes.

12. Në rast se në një anije, ka veçori ndërtimore që pengojnë realizimin e ndonjë prej këtyre dispozitave, duhet të bëhen masa të veçanta për të siguar që inspektorët të mund të imbarkohen dhe zbarkohen në mënyrë të sigurt.

ANEKS 4 RAPORTI I INSPEKTIMIT GFCM

1. INSPEKTORI/INSPEKTORËT

Emri Vendi anëtar Numri i dokumentit të identifikimit GFCM
.....

Emri Vendi anëtar Numri i dokumentit të identifikimit GFCM
.....

Emri Vendi anëtar Numri i dokumentit të identifikimit GFCM
.....

2. ANIJA INSPEKTUESE

2.1 Emri

.....

2.2 Flamuri

.....

3. INFORMACION MBI ANIJEN E INSPEKTUAR

3.1 Emri

.....

3.2 Flamuri

.....

3.3 Kapiteni (emri dhe adresa)

3.4 Pronari i anijes (emri dhe adresa)

.....



3.5 Numri i regjistrimit GFCM

.....

3.6 Lloji i anijes

4. VENDNDODHJA

4.1 Vendndodhja e përcaktuar nga kapiteni i anijes sipas..... UTC; Latitude..... Longitude.....

4.2 Vendndodhja e përcaktuar nga kapiteni i anijes sipas..... UTC; Latitude..... Longitude.....

5. DITA DHE ORARET E FILLIMIT DHE PËRFUNDIMIT TË INSPEKTIMIT

5.1 Data Ora e mbërritjes në bord UTC;

Ora e nisjes UTC

6. LLOJI I VEGLAVE TË PESHKIMIT NË BORD

Trata fundore – OTB	
Trata pelegjike – OTM	
Trata për karkaleca – TBS	
Koshilok – PS	
Njica/Mrezha – GNS	
Linja grepash/ pallangare – LLS	
Vegla peshkimi çlodhës-argëtues – RG	
Të tjera (specifiko)	

7. MATJA E SYZES (NË MILIMETRA)

7.1 Përmasa e syzes sipas parashikimeve ligjore

..... mm

7.2 Mesatarja e përmasave të syzes së matur mm

7.3 Kundërvajtje administrative: PO [] – JO [] – Nëse PO, referenca ligjore:

8. INSPEKTIM NË BORD TË ZËNIEVE

8.1 Rezultat mbi inspektimin në bord të zënieve

SPECIA (Kodi FAO <i>alpha code</i>)						
Totali (kg)						
Paraqitja						
Kampioni i inspektuar						
Përqindja e peshkut nëndimension						

8.2 Kundërvajtje administrative: PO [] – JO [] – Nëse PO, referenca ligjore:

9. INSPEKTIMI I DOKUMENTACIONIT NË BORD DHE VMS

9.1 *Logbook*: PO [] – JO []

9.2 Kundërvajtje administrative: PO [] – JO [] – Nëse PO, referenca ligjore:

9.3 Licenca e peshkimit: PO [] – JO []

9.4 Kundërvajtje administrative: PO [] – JO [] – Nëse PO, referenca ligjore:

9.5 Autorizim specifik: PO [] – JO []

9.6 Kundërvajtje administrative: PO [] – JO [] – Nëse PO, referenca ligjore:

9.7 VMS: PO [] – JO [] – funksional: PO [] – JO []

9.8 Kundërvajtje administrative: PO [] – JO [] – Nëse PO, referenca ligjore:

10. LISTA E SHKELJEVE

☐ Ka zhvilluar peshkim pa qenë i pajisur me licencë, leje ose autorizim të lëshuar nga CPC i flamurit – referenca ligjore:.....



- ☐ Nuk janë regjistruar zëniet dhe të dhënat e lidhura me to, në përputhje me kërkesat e raportimit të GFCM-së ose raportimi i pasaktë i zënieve dhe të dhënat e lidhura me to - referenca ligjore:
- ☐ Peshkim në një zonë të ndaluar – referenca ligjore:.....
- ☐ Peshkim gjatë sezonit të ndalimit – referenca ligjore:.....
- ☐ Përdorim i veglave të ndaluara peshkimi – referenca ligjore:.....
- ☐ Falsifikimi ose fshehja e qëllimshme e shenjave dalluese, identitetit ose regjistrimit të një anijeje peshkimi – referenca ligjore:.....
- ☐ Fshehja, manipulimi ose asgjësimi i provave që lidhen me hetimin e një shkeljeje – referenca ligjore:
- ☐ Shkelje të shumta, të cilat, të marra së bashku, përbëjnë një shpërfillje serioze të masave në fuqi në përputhje me GFCM-në – referenca ligjore:.....
- ☐ Dhuna, rezistenca, frikësimi, ngacmimi seksual, ndërhyrja ose pengimi i pajustificuar ose vonesa ndaj një inspektori të autorizuar – referenca ligjore:
- ☐ Ndërhyrja në sistemin e monitorimit satelitor dhe/ose operimi pa sistemin VMS - referenca ligjore:

11. LISTA E DOKUMENTEVE TË KOPJUARA NË BORD

12. KOMENTE DHE NËNSHKRIMI I KAPITENIT TË ANIJES

Nënshtkrimi i kapitenit të anijes.....

13. KOMENTET DHE NËNSHKRIMI I INSPEKTORËVE

Nënshtkrimi i inspektorëve

NJOFTIM

Nr. 2241/3, datë 28.2.2025

PËR HYRJEN NË FUQI TË NJË MARRËVESHJEJE NDËRKOMBËTARE

Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Kuvajtit në fushën e mbrojtjes së mjedisit, ruajtjes së burimeve natyrore dhe zhvillimit të qëndrueshëm, nënshkruar më 19.11.2014, ka hyrë në fuqi më 25.2.2025.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

KËRKESË

Shtetasi Bujar Jajezi, kërkon pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Jurisdiksionit të Përgjithshëm Tiranë, shpalljen të zhdukur të shtetasit Ermir Jajezi i datëlindjes 17.1.1981, lindur në Tropojë dhe me vendbanim të fundit në Tiranë, si dhe caktimin e palës kërkuese si kujdestar të pasurisë së shtetasit Ermir Jajezi.

KËRKUES
Bujar Jajezi

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 64 lekë

